



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 112/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Danush Ademi kryetar i Partisë Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës, te paraqitur për shkak të ndarjes së ulëseve në Kuvend, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Danush Ademi kryetar i Partisë Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës.

Arsyetim

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga Danush Ademi, me te cilën pretendohet se “PDAK është e dëmtuar me ndarjen e vendeve per kuvendin e Republikës se Kosoves nga KQZ, duke shkelur kushtetuten e Republikës se Kosoves ne nenin 64, dhe ne nenin 64 paragrafi 2pika (2). Dhe njekoheisht, edhe ligji per zgjedhjet e pergjithshme i cili eshte bazuar ne kushtetuten e Republikës se Kosoves: Ligji per zgjedhjet e pergjithshme.

Neni 111 Ndarja e vendeve

111.1 Vendet ne kuvend ndahen sipas sistemit te perfaqesimit te caktuar nga neni 64 i Kushtetutes se Republikës se Kosoves, duke ndare:

a) njeqind (100) vende midis te gjitha subjekteve politike te certifikuara ne raport me numrin e votave te vlefshem qe kane marre ato : dhe

b) (i)

(ii)partit, kualicionet , nisma qytetare dhe kandidate e pavarur, te cilet jan deklaruar se perfaqesojn komunitetet e tjera, ne kuvend do te ken numrin e fituara ne zgjedhejet e hapura me minimumin e vendeve te garantuara si ne vijem: komuniteti rom (1) vend, komuniteti ashkali nje (1) vend, komuniteti egjiptjan (1) vend dhe nje vend

shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali ose egjiptjan, që ka numrin më të madh të votave të pergjithshme....

(Dhe në bazë të rezultateve në këto dy vende të rezervuara i ka të fituara PDAK-ja nga neni 111.1 shkronja b) në shkronja (ii))”.

Parashtruesi i ankesës thekson se “nëse i referohemi nenit 111.1 shkronja a), atëherë PDAK është demtuar ngase nuk është përfshirë në ndarje të vendeve për kuvendin e Kosovës, sepse për këto flet edhe neni 111.2 dhe shkronja a) e po këti neni 111.2 ngase partit minoritare nuk i nënshtrohen pragut zgjedhor i cili është 5%. Dhe për ndarje flet me tutje ky nen në shkronjen b), c), d), e). Dhe koficienti i fituar nga qendra e numerimit më dalje të votuesve e cila për PDAK-në është 0.41%, e cila duhet të mbetet në garë për ndarje të 100 ulseve në Parlamentin e Kosovës, dhe ky koficient mban ulsen e 94 nga gjithsej 100. Dhe marr në pergjithësi PDAK ka 3 ulese në parlamentin e Kosovës duke përfshirë edhe dy venet e rezervuara për komunitetet . Gjithmone duke ju referuar rezultateve dhe ligjit për zgjedhjet e pergjithshme 03/L-073 i bazuar në Kushtetuten e Republikës së Kosovës. Me shpresë se nuk ju bezdisem shumë dhe me shpresë se nuk do të kemi nevojë të shkojmë edhe me tutje me ankesa”. Prandaj parashtruesi i ankesës kërkon korrigjimin e vendeve.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b) një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Për të vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesi i ankesës PZAP i bëri një kërkesë KQZ-së më datë 31.01.2011, për sqarim dhe KQZ iu përgjigj kësaj kërkesë me datë 01.02.2011, lidhur me dëmtimin e subjektit politik PSDAK me ndarjen e vendeve për deputet në kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe se KQZ njofton se ndarja e vendeve për Kuvendin Republikës së Kosovës bëhet në pajtim me nenin 111 të LZP-së nr.03/L-073, paragrafi b pika ii për ndarjen e 10 vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë jo shumicë dhe joserbe në Kosovë.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitësa në Prishtinë

A nr. 112/2011 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

